



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 97, datë 29.07.2020

PËR

DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 58, DATË 30.06.2015 “MBI MASAT E VIGJILENCËS SË DUHUR DHE TË ZGJERUAR NGA SUBJEKTET E LIGJIT MBI PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT”, E NDRYSHUAR.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Zbatueshmërisë për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE

Në Rregulloren nr. 58, datë 30.06.2015 “Mbi masat e vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar nga subjektet e ligjit mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, e ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në **nenin 3**, shprehja “*sipas germave e) dhe ë)...*” ndryshohet në: “*sipas germave e), ë),j) dhe pika I ...*”;

Shtohen dy paragrafë të fundit më këtë përmbajtje:

“- Shoqëritë administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe të fondeve të pensioneve, si dhe agjentët e tyre

- çdo person fizik ose juridik, i cili merret me ofrimin e shërbimeve të mjeteve virtuale”.

2. Në **nenin 5**, paragrafi i katërt, pas shprehjes “*përtej procedurave “Njihe klientin tënd”*,” shtohet shprehja “*si dhe masave të “Vigjilencës së duhur”*”;

Pas paragrafit të pestë shtohen paragrafë të tjerë me këtë përmbajtje:

“Vigjilencë e thjeshtuar” është një tërësi masash që zbatohet nga subjektet e ligjit për vendosjen dhe monitorimin e marrëdhënies së biznesit me klientët, produktet dhe shërbimet e ofruara, të cilët paraqesin një nivel të ulët risku për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

“Financim i terrorizmit” ka të njëjtin kuptim si në nenet 230/a deri në 230/ç të Kodit Penal.

“Transaksion” është një shkëmbim dhe/ose ndërveprim, që përfshin dy ose më shumë palë, apo një veprim i kërkuar nga klienti për llogari të tij pa përfshirjen e palëve të tjera.

“Transaksione të lidhura me njëri-tjetrin” janë dy ose më shumë transaksione (duke përfshirë transfertat e drejtpërdrejta), ku secila prej tyre është më i vogël se sa shuma e përcaktuar si prag, në bazë të nenit 4 të këtij ligji dhe kur këto transaksione në shumë totale barazojnë ose tejkalojnë shumën e pragut të zbatueshëm.

“Procedura njihe klientin tënd” nënkupton një sërë rregullash, të përdorura nga subjektet e këtij ligji, që kanë të bëjnë me politikën e pranimit e të identifikimit të klientit dhe administrimit të riskut të tyre.

“Mjet virtual” është një pasqyrim digjital i një vlere që mund të tregtohet apo të transferohet në formë digjitale, si dhe që mund të përdoret për qëllime pagesash ose investimesh, duke përfshirë por pa u kufizuar te kriptomonedha. Në këtë përkufizim nuk përfshihen pasqyrimet digjitale të monedhave të njohura zyrtarisht si të nxjerra nga bankat qendrore, të letrave me vlerë dhe mjeteve të tjera financiare që janë parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

“Ofrues i shërbimeve të mjeteve virtuale” nënkupton çdo person fizik ose juridik, i cili kryen, për ose në emër të një personi tjetër fizik ose juridik, një ose më shumë nga këto aktivitete:

i) shkëmbimi ndërmjet mjeteve virtuale dhe monedhave të njohura zyrtarisht;

ii) shkëmbimi ndërmjet mjeteve virtuale dhe pasurive të çdo lloji;

iii) shkëmbimi ndërmjet një ose më shumë formave të mjeteve virtuale;

iv) transferimi i mjeteve virtuale;

v) ruajtja dhe/ose administrimi i mjeteve virtuale ose instrumenteve që mundësojnë kontroll mbi mjetet virtuale;

vi) pjesëmarrja dhe sigurimi i shërbimeve financiare lidhur me ofertën e një emetuesi dhe/ose shitjen e një mjeti virtual.

Në kuptim të kësaj pike, transferimi nënkupton kryerjen e transaksionit për llogari të një personi tjetër fizik apo juridik, që lëviz mjetin virtual nga adresa e mjetit virtual ose llogaria e një personi tjetër.

“Palë e tretë”, nënkupton subjekt të mbikëqyrur nga autoritetet kompetente, detyrimisht të regjistruar në Shqipëri, në një nga shtetet anëtare të Bashkimit Europian apo shtete të treta, me kusht që të plotësojnë kushtet si më poshtë:

a) të jenë të rregulluara me ligj të posaçëm dhe të detyruara për t’u regjistruar në vendin përkatës; si dhe

b) të jenë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose në një vend të tretë, me kusht që të zbatojnë kërkesa të njëjta ose më të larta me ato të vendosura nga ky ligj për vigjilencën e duhur dhe të zgjeruar, identifikimin e klientit dhe të pronarit përfitues, ruajtjen e informacionit, si dhe të mbikëqyren nga autoritetet kompetente për përputhshmërinë për çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit.”

3. Në nenin 6, pika 1, shprehja “Subjektet e Ligjit nr. 9917, date 19.05.2008” bëhet: “Subjektet”.

Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf më këtë përmbajtje: “Subjektet marrin masat e ‘vigjilencës së thjeshtuar’, ‘vigjilencës së duhur’ dhe ‘vigjilencës së zgjeruar’ në rastet e përcaktuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.”

Pika 2, në fund të fjalisë dy shtohet shprehja: “ose dokument elektronik që plotëson kushtet e vlerësimit, sipas legjislacionit në fuqi për dokumentin elektronik ose nënshkrimin elektronik.”

Në pikën 5 shprehja “në kreun III të Ligjit”, ndryshohet në “në kreun II dhe III të Ligjit”.

Pas pikës 6, shrohen 6 pika të tjera si më poshtë:

“7. Subjektet hartojnë politika, udhëzime apo procedura të brendshme për pranimin, identifikimin, regjistrimin, monitorimin, administrimin e rrezikut si dhe raportimin e transaksioneve të klientëve. siç përcaktohet në nenin 2, pika 21, si dhe në nenin 11 dhe 12 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

8. Subjektet hartojnë rregullat dhe procedurat e nevojshme për zbatimin e masave kundër financimit të terrorizmit, të cilat parashikojnë në veçanti hapat që duhet të ndjekin, rolin e strukturave të subjekteve në këtë proces si dhe autoritetin ku duhet të raportojnë, me qëllim sigurimin e parandalimit të lëvizjes dhe përdorimit të fondeve të personave dhe subjekteve të përfshirë në financimin e terrorizmit apo prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë, në përputhje me listat e personave të shpallur dhe sanksioneve përkatëse të përcaktuara në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

9. Për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientëve subjektet duhet të kërkojnë praninë fizike të klientëve dhe të përfaqësuesve të tyre, para se të vendosin një marrëdhënie biznesi.

10. Subjektet miratojnë dhe zbatojnë procedura specifike të administrimit të rrezikut në rastet e transaksioneve apo marrëdhëniet e biznesit, të kryera pa praninë fizike të klientit.

11. Subjektet duhet të zbatojnë politika dhe të marrin masat e duhura, sipas rastit, për identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, që lidhen me:

a) Zhvillimet e produkteve të reja, praktikave të biznesit, mënyrat e ofrimit apo kanalet e shpërndarjes;

b) Përdorimin e teknologjive të reja apo atyre që janë në zhvillim.

Këto masa duhet të zbatohen përpara futjes në përdorim të produkteve të reja dhe praktikave të biznesit apo teknologjive të reja, për produktet e reja dhe ekzistuese, në mënyrë që të administrohen dhe të ulen rreziqet e identifikuara.

12. Subjektet në rastin kur mbështeten në palë të treta, zbatojnë kërkesat e parashikuara në nenin 6/1 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.”.

- 4. Në nenin 8, pika 4, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: “Subjektet parashikojnë në procedurat e brendshme të punësimit, edhe kritere mbi pastërtinë e figurës dhe integritetin të punonjësve, veçanërisht të atyre të përfshirë në procesin e parandalimit të pastrimit të**

parave dhe financimit të terrorizmit, me qëllim parandalimin e rrezikut të përfshirjes së tyre në veprimtari kriminale, të pastrimit të parave, mashtrimit, etj.”;

Në pikën 6, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: *“Përveç kategorive të parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave, subjektet mund të përcaktojnë dhe kategori të tjera rreziku duke iu referuar Udhëzuesit “Për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”, apo Ankeseve, bashkëngjitur kësaj Rregulloreje.”*;

Në pikën 8, shprehjes: *“Nëse ligjet e vendit ku janë vendosur filialet apo degët parashikojnë pengesa për zbatimin e detyrimeve...”* i shtohet togfjalëshi *“...dhe të masave parandaluese”*.

Pika 11 me këtë përmbajtje *“Subjektet marrin masa për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit, bazuar në kreun III të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave”*, shfuqizohet.

5. Në **nenin 9**, pika 1, në fund të paragrafit shtohet shprehja me këtë përmbajtje: *“ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, të kryera si një transaksion i vetëm ose si transaksione të lidhura me njëra tjetrën brenda 24 orëve”*.
6. Në **nenin 10**, pika 1, pas fjalës *“mbikëqyr”* shtohet togfjalëshi *“nëpërmjet inspektimeve”*.
7. **Shtohet Neni 10/1** me këtë përmbajtje:

“Neni 10/1

Masat Mbikëqyrëse dhe Ndëshkimore

1. *Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare merr masa mbikëqyrëse dhe ndëshkimore ndaj subjekteve të kësaj rregulloreje, siç përcaktohet në ligjin nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe legjislacionin në fuqi që rregullon veprimtarinë e tyre, nëse konstaton se këto subjekte nuk zbatojnë kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.*
2. *Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, kur e gjykon të arsyeshme, mund të kufizojë, pezullojë apo të revokojë licencën e subjektit, në rastet kur kërkohet nga autoriteti përgjegjës, sipas ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”.*
3. *Autoriteti mbikëqyrës shqyrton kërkesën e autoritetit përgjegjës, bazuar në dokumentacionin shoqëruar të saj, i cili paraqet të dhëna ose dyshime, të bazuara në rrethana dhe fakte konkrete dhe vendos për pranimin ose refuzimin e saj, në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e tij dhe të subjekteve të licencuara dhe mbikëqyrura prej tij.”*
8. Në **nenin 11** ndryshon titulli nga *“Dispozita të tjera”*, në *“Kërkesa Raportuese”*.

Hiqet paragrafi i parë me këtë përmbajtje: *“Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të saj, janë të detyruara të kryejnë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje rishikimin dhe/ose miratimin, e rregulloreve dhe procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.”*

Në fund, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: *“Subjektet e kësaj rregulloreje raportojnë menjëherë pranë Autoritetit, sapo konstatojnë ndodhjen e një ngjarjeje madhore/kryesore, në menaxhimin dhe funksionimin e subjektit.”*

9. Në nenin 12, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të saj, janë të detyruara të kryejnë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje rishikimin dhe/ose miratimin, e rregulloreve dhe procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.”

10. Në Udhëzuesin “Për matjen e rrezikut nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit”, Kapitulli V me titull “Hapat e matjes së rrezikut”, germa b) shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu përveç rishikimit dhe ridorëzimit të profilit të riskut nga vetë subjekti, Autoriteti me raportimin e ngjarjeve madhore/kryesore nga subjekti kryen kategorizimin e riskut, sipas procedurave të percaktuara në këtë udhëzues, për subjektin raportues. Subjekti mund të konsiderojë ngjarje madhore psh. çdo bashkim, konsolidimin, riorganizimin ose rikapitalizimin e Subjektit ose ndonjë shitje të të gjithë ose një pjese të konsiderueshme të aktiveve të Subjektit dhe Filialet e saj, të marra në tërësi.”

11. Në Ankes II, pika 1, paragrafi i parë, shprehja *“të ligjit 10198, datë 10.12.2009...”* zëvendësohet me *“të ligjit nr. 56, datë 20/06/2020...”*